



UNIVERSITETI I TIRANËS
Senati Akademik

VENDIM

Nr. 9, datë 26.04.2017

“Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2017-2018”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 3, gërma c; neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 e 2; neni 38, pika 1, gërma a; në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 19, pika 2 dhe neni 49, pikat 1.2 e 2.1; si dhe në propozimet e njëjësive kryesore të UT-së, në mbledhjen e datës 26.04.2017 Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimit në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2017-2018, në programet e studimeve të ciklit të parë, si dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, me kohë të plotë, janë **6444** të ndara, si më poshtë vijojnë:
 - a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, si dhe në një program të integruar të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë **6026**
 - b) Kuota për program të dytë studimi **98**
 - c) Kuota për transferim studimesh **270**
 - d) Kuota për shtetasit e huaj **50**
2. Kuotat e pranimeve të reja, sipas shkronjës ”a”, të pikës 1, të këtij vendimi, përbëhen nga:
 - a) Kuotat e pranimit për kandidatët brenda territorit të vendit (sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur) **5631**
 - b) Kuotat për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit **235**
 - c) Kuotat për kategoritë e veçanta **160**
3. Shpërndarja e kuotave sipas pikave 1b; 1c; 1d; 2b; 2c, të kryhet nga Rektorati pas përfundimit të aplikimit nga kandidatët.
4. Ky vendim i përcillet për njohje në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PROF.DR.MYNYR KONI

Kuotat e pranimit në Universitetin e Tiranës, në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" dhe në një program të integruar të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, me kohë të plotë për vitin akademik 2017-2018

	FAKULTETI	Lloji i programit të studimit	Emërtimi i programit të studimit	Kuotat e pranimit për kandidatët brenda vendit
1	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë	Bachelor	Histori	180
2		Bachelor	Gjeografi	180
3		Bachelor	Gjuhë- Letërsi	180
4		Bachelor	Gazetari	120
5		Bachelor	Arkeologji, me drejtim Arkeologji dhe Trashëgimi kulturore	100
6	Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Bachelor	Biologji	100
7		Bachelor	Bioteknologji	100
8		Bachelor	Matematikë	100
9		Bachelor	Fizikë	100
10		Bachelor	Informatikë	200
11		Bachelor	Kimi	100
12		Bachelor	Kimi dhe Teknologji Ushqimore	100
13		Bachelor	Kimi Industriale dhe Mjedisore	100
14		Bachelor	Inxhinieri Matematike dhe Informatike	100
15	Bachelor	Teknologji Informacioni	100	
16	Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	Bachelor	Gjuhë Angleze	240
17		Bachelor	Gjuhë Frënge	140
18		Bachelor	Gjuhë Gjermane	140
19		Bachelor	Gjuhë Italiane	150
20		Bachelor	Gjuhë Greke	85
21		Bachelor	Gjuhë Turke	85
22		Bachelor	Gjuhë Ruse	85
23		Bachelor	Gjuhë Spanjolle	95
24	Fakulteti i Shkencave Sociale	Bachelor	Psikologji	110
25		Bachelor	Punë sociale	100
26		Bachelor	Filozofi	80
27		Bachelor	Sociologji	81
28		Bachelor	Shkenca Politike	100
29		Bachelor	Administrim dhe Politika Sociale	100
30	Fakulteti i Ekonomisë	Bachelor	Administrim Biznes	460
31		Bachelor	Ekonomiks	110
32		Bachelor	Financë	460
33		Bachelor	Informatikë Ekonomike	250
34	Fakulteti i Drejtësisë	Program	Drejtësi	750
35	Filiali i UT-së Sarandë	Bachelor	Administrim Biznes	100
36		Bachelor	Gjuhë Angleze	50
			Gjithsej UT - Bachelor	5631